

AKT THEMELIMI DHE STATUT "LIBER IT" SHPK

---

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTII  
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
" LIBER IT " SHPK

---

*Q*

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " LIBER IT " SHPK**

**STATUT**

**PER KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK, SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE  
KUFIZUAR: "LIBER IT" SHPK**

Sot më datë 19.08.2023, unë shtetasi si më poshtë, vijon:

z. BARTOSZ LIBERACKI, Shtetas Polak, atësia Mariusz lindur më 03.02.1989, në POLONI dhe resident POLAK, mbajtës I Kartes Identitetit me numër Personal: 89020315891, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

Në mbështetje të dispozitave ligjore të Kodit Civil në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, vendosa themelimin e Shoqërisë Tregtare "LIBER IT" SH.P.K., shoqëri private e së drejtës Shqiptare, krijimi, funksionimi I së cilës përcaktohet si më poshtë vijon:

**KREU**

**EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1**

**EMERTIMI I SHOQERISE**

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi së kufizuar është " LIBER IT " SH.P.K. (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), person juridik privat I së drejtës Shqiptare. I themeluar dhe do të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Kjo shoqëri në llojin e saj është Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuara.
- 1.2 Veprimtaria dhe funksionimi I kësaj Shoqërie rregullohet sipas nenëve të statutit të kësaj shoqërie dhe në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**NENI 2**

**SELIA**

- 2.1 Selia Fillestare (Përkohshme) për Regjistrimin e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Pjeter Bogdani, Njesia Nr.5, Z.K. 8270, Vell. 92 Fq. 35, Ap nr. 29, Nr. Pasurie, 3/60 +1-32, Tirane.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3**

**VULA E SHOQERISE**

- 3.1 Shoqëria ka vulën e saj, do të jetë si vijon: **“LIBER IT” sh.p.k.**
- 3.2 Të gjitha Aktet dhe dokumentat që do të nxjerrë Shoqëria drejtuar palëve të treta dhe publikut duhet të tregojnë qartë dhe të lexueshëm emërtimin (lojin) e Shoqërisë dhe pas emrit do të jenë fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose shkurtimi sh.p.k. **“LIBER IT” sh.p.k.**
- 3.3 Shoqëria ka adresën e saj elektronike: [liberackibartosz@gmail.com](mailto:liberackibartosz@gmail.com)
- 3.4 Shoqëria ka nr. Kontakt të saj: +48 729 922 192

#### NENI 4

##### OBJEKTI I SHOQERISE

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në **Menaxhimi, blerja, shitja, dhënia me qira e pronave të paluajtshme si edhe ndërmjetesimi për shitje blerje apo, dhënie me qira të pronave të paluajtshme midis personave fizike, personave juridike private dhe publike si dhe nga shteti si dhe çdo veprim tjetër i ligjshëm që ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme.**
- 4.2 Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria:
- Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse;
  - Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronarë truallë apo objektesh, operatorë dhe administrues të strukturave turistike;
  - Mund të kryejë të gjithë veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të bëjnë, përfshirë par pa u kufizuar në: ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe se të treta, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe do veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundeson një përdorim me të mirë të strukturave dhe/ose burimeve nepermjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.
- 4.3 Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë do aktivitete tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushje ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

#### NENI 5

##### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

- 5.1 Shoqëria do të zhvillojë Veprimtarinë e saj për një kohë pa afat.
- 5.2 Ajo mund të shpërndahet para afatit me vendim të Ortakut, ose për shpërndarje e saj e percakton vetë legjislacioni në fuqi.

#### KREU II

## KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

### NENI 6 KAPITALI I SHOQERISE

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin dhënë nga çdo ortak në Shoqëri. Çdo Ortak zotëron një kuotë të vetme në Shoqëri. Bashkezotëruesit e një kuote, sipas nenit 72, të këtij ligji, gëzojnë cilësinë si një ortak i vetëm.
- 6.2 Kapitali Fillestar do të jetë: 20 000 Eur, konvertuar me Kursin eur/lek dt 18.08.2023 sipas Bankes së Shqipërisë (1 eur =106.01 lek) është 2.120.200 lekë (Dy million e Njëqind e Njzetë mijë e Dyqind lekë). Pjesëmarrja e themeluesit në Kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributet e tij si më poshtë:
- z. **BARTOSZ LIBERACKI**, Shtetas Polak, atësia **Mariusz** lindur më **03.02.1989**, në **POLONI** dhe resident **POLAK**, mbajtës i Kartes Identitetit me numër Personal: **89020315891**,  
Zotërues I, 1 kuotë të vetme me vlerën totale nominale: 2.120.200 lekë (Dy million e Njëqind e Njzetë mijë e Dyqind lekë).
- Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortaku që zotëron, 100 % (njëqind per qind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë.
- 6.3 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejte me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

### NENI 7 KALIMI I KUOTAVE ME TRASHEGIMI OSE SI PASOJE E FALIMENTIMIT

- 7.1 Në rast se një ortak apo një bashkezotërues i një kuote humb jeten, trashëgimtarët e tij do të jenë të vetmet persona që do të njihet titulli mbi kuotën nga Shoqëria por asnjë nga këto parashikime nuk liron përgjegjësitë e trashëgimtareve nga çdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruara. Në rastin e vazhdimit të Shoqërisë me disa trashëgimtare të ortakut që ka humbur jeten, trashëgimtarët duhet të caktojnë një përfaqësues të përbashkët.
- 7.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mesipër zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse personi i mesipër zgjedh të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër atëherë ai duhet ta kryejë atë nëpërmjet një akti të vlefshëm të transferimit të kuotës.
- 7.3 Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në do mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në regjistrin tregtar si zotërues i kuotës.

### NENI 8

## ZMADHIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do të komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 8.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejte me kuotat që zoterojnë në Shoqëri.
- 8.3 Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panëshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë serish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejte me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

## NENI 9

### ZVOGELIMI KAPITALIT

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogelojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogelohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.
- 9.2 Ortakët e përballojnë zvogelimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejte me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

## KREU III

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME NENI 10 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose do marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.
- 10.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.
- 10.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.
- 10.4 Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votes për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht për pjesën e mbetur.
- 10.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë

telekonferencën (*conference call*) audio ose video, në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.

- 10.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/et ose nga ortakët që

përfaqesojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të behët nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, derguar secilit prej ortakeve në adresat e njoftuara Shoqërisë, të paktën 15 (pese mbledhjet) dite përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

10.7 Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.

10.8 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për do mbledhje midis personave të pranishëm.

10.9 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakeve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.

10.10 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

10.11 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë me shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara me poshtë në nenin 9.12. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.

10.12 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të  $\frac{3}{4}$  të ortakeve pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zotërojnë me shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

## KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### NENI 11 ADMINISTRIMI I SHOQERISE

11.1 Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej 5 (pese) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.

11.2 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të

Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.

11.3 Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja

e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretet e deleguar për ad

ministrimin e Shqerise.

11.4 Administratori do te veproje ne cdo kohe vetem ne interesin me te mire te Shqerise. Ne rast konfliktit te interesit. Administratori do te njoftoje menjehere ortaket si dhe do te heqe dorë nga cdo veprim qe lidhet me objektin e konfliktit te interesit deri ne marrjen e udhezimeve nga Asambleja e Pergjithshme.

11.5 Administratori i parë i Shqerise do te jetë:

- ♦ z. BARTOSZ LIBERACKI, Shtetas Polak, mbajtes i Kartes Identitetit me nr. Personal: 89020315891.

## NENI 12

### SHPERBLIMI I ADMINISTRATORIT

12.1 Asambleja e Pergjithshme percakton shperblimin e Administratorit te Shqerise.

## NENI 13

### PERFUNDIMI I DETYRES SE ADMINISTRATORIT

13.1 Detyra e Administratorit perfundon ne rast se:

- i perfundon mandatin;
- shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme;
- jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar Shqerine;
- personi nuk gazon cilesine e Administratorit sipas parashikimeve te ligjit;
- mungon pa arsye ne detyre per me shume se 6 (gjashte) muaj radhazi

dhe Asambleja e Pergjithshme vendos ta shkarkoje nga detyra.

## KREU V

### KONTROLI FINANCIAR I SHOQERISE, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI

## NENI 14

### KONTROLI FINANCIAR

14.1 Kontrolli financiar i Shqerise kryhet ne perputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Pergjithshme do te emeroje ne apo me shume Eksperte

Kontabël te Autorizuar ne ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kerkohet ne baze te ligjit.

## NENI 15

### VITI FINANCIAR

15.1 Viti Financiar i Shqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te do viti.

## NENI 16 BILANCI VJETOR

- 16.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe te Ekspertit Kontabel te Autorizuar (nese jane emeruar) miratohen nga Asambleja e Pergjithshme. Administratori i paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme raportin mbi administrimin e Shoqerise si edhe llogarite vjetore.
- 16.2 Dokumentet qe kane te bejne me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Pergjithshme brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

## NENI 17 DIVIDENDI

- 17.1 Pasi te jene permushur kerkesat e percaktuara nga Ligji per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqeria, me shumice te kualifikuar te votave se Asamblese Pergjithshme, mund te vendose shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.
- 17.2 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe i bashkengjiten kuotave, te gjithe dividendet duhet te deklarohen dhe paguhen sipas shumave te paguara ne kuotat ne te cilat paguhet dividendi. Te gjitha dividendet do te shperndahen dhe paguhen ne menyre proporcionale me shumat e paguara mbi kuotat gjate do pjese ose pjeseve te periudhes ne te cilen paguhet dividendi.



AKT THEMELIMI DHE STATUT " LIBER IT " SHPK

**KREU VI**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM,**  
**ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

**NENI 18**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

18.1 Ne rastin e prishjes dhe likuidimit te Shoqerise do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

**NENI 19**  
**LIGJI I ZBATUESHEM**

19.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete akt, do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushen e shoqerive tregtare.

**NENI 20**  
**ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

20.1 Mos marrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqerise dhe ortakeve, apo ndërmjet ortakeve dhe trashëgimtareve te ortakeve ose ortakeve te tjere dhe/ose Shoqerise, qe kane per objekt te drejta te lidhura me Shoqerine, do te zgjidhen miqesisht ndërmjet paleve te interesuara. Ne rast se palet nuk arrijne nje zgjidhje miqesore, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë do te jete kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe:

**ORTAKU VETEM I SHOQERISE: "LIBER IT" SHPK**

**BARTOSZ LIBERACKI**

*BARTOSZ LIBERACKI*

*dibendi*

